REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

"Për bashkëpunim në hartimin dhe përgatitjen e akteve noteriale të dhurimit të apartamenteve në kuadër të procesit të rindërtimit"

Bashkia Durrës, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, "Për noterinë", i ndryshuar, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar, në kuadër të përfundimit të procedurave për kalimin e pronësisë së apartamenteve tek familjet përfituese nga programi i rindërtimit, fton noterët e licencuar, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, të shprehin interesin dhe gatishmërinë për bashkëpunim me Bashkinë Durrës për hartimin, përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve noteriale të dhurimit të apartamenteve në favor të familjeve përfituese.

Noterët e interesuar duhet të paraqesin pranë Bashkisë Durrës:

a. kopje të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit;
b. të dhënat e kontaktit dhe adresën e zyrës noteriale;
c. informacion të detajuar mbi tarifat e aplikueshme për shërbimet noteriale që lidhen me hartimin dhe nënshkrimin e akteve të dhurimit.

Shprehjet e interesit, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të dorëzohen pranë Bashkisë Durrës, nëpërmjet adresës elektronike info@durres.gov.al, brenda datës 20.11.2026.

Për informacione të mëtejshme, të interesuarit mund të kontaktojnë Bashkinë Durrës në adresën elektronike të mësipërme.

DREJTORIA LIGJORE

BASHKIA DURRËS